

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	11.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me çmimin e produkteve ushqimore.	11.02.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës ka hapur në fund të vitit 2025 një procedurë monitorimi për produktet e shportës, duke u fokusuar tek supermarketet. Autoriteti i Konkurrencës është në proces analizimi të trendit të çmimeve, për të vlerësuar dinamikën e tregut dhe për të identifikuar nëse ka elementë, që mund të rezultojnë në sjellje të mundshme në kundërshtim me rregullat e konkurrencës. Çdo vlerësim konkret do të bëhet në përfundim të analizës së plotë dhe në përputhje me procedurat ligjore, në këndvështrim të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.	E plotë	Nuk ka
2.	20.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me proceset e emërimit/zgjedhjes së zyrtarëve të nivelit të mesëm	27.02.2026	Kthim përgjigje duke bërë me dije se për periudhën 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka pasur vende të lira pune në pozicione të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues të	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		dhe të lartë drejtues, CV-të dhe masat administrative në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.		shërbimit civil. Procedurat e ndjekura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil, për vendet vakante të shpallura, gjenden të publikuara në faqen zyrtare, sipas linkut https://caa.gov.al/publication-s-category/vende-vakante2/ . Për sa i përket masave administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, gjatë periudhës 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka marrë masa administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. Në lidhje me transparencën e të emëruarve/zgjedhurve ju bëjme me dije se në faqen zyrtare të institucionit gjenden të publikuara përmbledhje të jetëshkrimit të anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës, si dhe drejtorëve të drejtorive, sipas linkut https://caa.gov.al/autoriteti-i-konkurrences/organizimi/ .		
3.	18.03.2026	Kërkesë për informacion mbi mënyrat zyrtare të ankesës mbi çmimet e fryra dhe të pajustificuara të biletave të transportit publik ndërqytetas Tiranë-Bulqizë dhe anasjelltas.	19.03.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në lidhje me ankesat mund të plotësoni formularin, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, linku bashkëlidhur https://caa.gov.al/laws/formular-i-ankeses/ , ose mund të paraqiteni pranë ambienteve të institucionit tonë, në adresën rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë, 1004, orari e hënë – e enjte 08:00 –	E plotë	Nuk ka

				16:30 dhe e premte 08:00 – 14:00.		
--	--	--	--	--------------------------------------	--	--

Nuk ka kërkesa të tjera për informacion të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës.